



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.132

11 tetor

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 84/2012 datë 18.9.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të modernizimit të asistencës sociale	7593
Ligj nr. 85/2012 datë 18.9.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar	7605
Ligj nr. 86/2012 datë 18.9.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar	7613
Ligj nr. 87/2012 datë 18.9.2012	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 16.8.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre”	7618
Ligj nr. 88/2012 datë 18.9.2012	Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar	7618
Vendim i Kuvendit nr. 37/2012, datë 18.9.2012	Për rrëzimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar	7620

LIGJ
Nr. 84/2012

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD) PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT TË MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS SOCIALE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të modernizimit të asistencës sociale.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.9.2012

**Shpallur me dekretin nr.7775, datë 9.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

HUAJA NUMËR 8141 - AL

MARRËVESHJA E HUAS
(PROJEKTI I MODERNIZIMIT TË NDIHMËS SOCIALE)
NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Marrëveshje e datës _____, 201_, ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka). Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përcaktohen në bashkëlidhjen e kësaj marrëveshjeje) janë pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje.



1.02 Përveçse kur kërkohet ndryshe nga konteksti, termat me shkronjë kapitale të përdorur në këtë marrëveshje kanë kuptimin e përcaktuar në kushtet e përgjithshme ose në bashkëlidhjen e kësaj marrëveshjeje.

Neni 2 Huaja

2.02 Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara apo të përmendura në këtë marrëveshje, shumën prej tridhjetë e tetë milionë euro (38,000,000 euro), shumë, e cila mund të konvertohet herë pas here nëpërmjet konvertimit të monedhës në përputhje me dispozitat e paragrafit 2.07 të kësaj marrëveshjeje (huaja), për të ndihmuar financimin e projektit të përshkruar në programin 1 të kësaj marrëveshjeje (projekti).

2.03 Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e huas në përputhje me seksioni IV të programit 2 të kësaj marrëveshjeje: a) në lidhje me pjesën 1 të projektit, si rimbursim të një pjese të programit të miratuar të shpenzimeve; b) në lidhje me pjesën 2 të projektit për të financuar shërbimet e konsulentëve dhe kostot operative; dhe (c) në lidhje me tarifën fillestare të referuar në paragrafin 2.03 të kësaj marrëveshjeje.

2.04 Tarifa fillestare e pagueshme nga Huamarrësi do të jetë e barabartë me çerekun e një pike përqindjeje (0.25%) të shumës së huas.

2.05 Interesi i pagueshëm nga Huamarrësi për secilën periudhë interesi do të jetë në një përqindje të barabartë në përqindjen e referencës për monedhën e huas plus shtrirjen e ndryshueshme; për sa kohë që në momentin e konvertimit të të gjithë apo një pjese të principalit të huas, interesi i pagueshëm nga Huamarrësi gjatë periudhës së konvertimit mbi këtë shumë do të përcaktohet në përputhje me dispozitat përkatëse të nenit IV të kushteve të përgjithshme. Pavarësisht nga sa më sipër, nëse ndonjë shumë e bilancit të tërhequr të huas mbetet e papaguar në datën kur duhet të paguhet, dhe kjo mospagesë vazhdon për një periudhë prej tridhjetë ditësh, atëherë interesi i pagueshëm nga Huamarrësi do të llogaritet sipas parashikimit të paragrafit 3.02 (e) të kushteve të përgjithshme.

2.06 Datat e pagesës janë 15 mars dhe 15 shtator të çdo viti.

Principalit të huas do të shlyhet në përputhje me grafikun e amortizimit të përcaktuar në programin 3 të kësaj marrëveshjeje.

2.07 a) Huamarrësi mund të kërkojë në çdo kohë ndonjë prej konvertimeve të termave të huas, me qëllim që të lehtësohet menaxhimi i matur i borxhit: i) një ndryshim të monedhës së huas për të gjithë ose çdo pjesë të principalit të huas, të tërhequr apo të patërhequr, në një monedhë të miratuar; dhe ii) një ndryshim të bazës së përqindjes së aplikueshme të interesit për të gjithë ose çdo pjesë të principalit të huas, të tërhequr dhe të papaguar, nga një normë e ndryshueshme në një normë fikse, ose anasjellas, ose nga një normë e ndryshueshme e bazuar në një shtrirje të ndryshueshme në një normë të ndryshueshme e bazuar në një shtrirje fikse.

b) Çdo konvertim i kërkuar në përputhje me paragrafin (a) të këtij seksioni, i cili pranohet nga Banka do të konsiderohet një "konvertim", siç përkufizohet në kushtet e përgjithshme dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit IV të kushteve të përgjithshme dhe udhëzimeve të konvertimeve.

Neni 3 Projekti

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të zbatojë projektin nëpërmjet MPÇSSHB-së, në përputhje me dispozitat e nenit V të kushteve të përgjithshme.

3.02 Pa kufizime ndaj dispozitave të paragrafit 3.01 të kësaj marrëveshjeje, dhe përveç rasteve kur Huamarrësi dhe Banka bien dakord ndryshe, Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSH-së, siguron që projekti të zbatohet në përputhje me kushtet e programit 2 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 4 **Masat e Bankës**

4.01 Rastet shtesë të pezullimit përfshijnë rastet kur:

a) Programi i ndihmës ekonomike është ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar apo hequr dorë në mënyrë të tillë që cenohet, materialisht dhe negativisht aftësia e Huamarrësit për të arritur objektivat e projektit.

b) Huamarrësi ka ndërmarrë veprime që mund të kenë sjellë ndryshimin e një treguesi të lidhur me disbursimet, i cili është realizuar dhe në lidhje me të cilin është disbursuar shuma përkatëse e treguesit të lidhur me disbursimet.

4.02 Rasti shtesë i përshpejtit përfshin situatën kur rastet e përcaktuara në paragrafin 4.01 të kësaj marrëveshjeje ndodhin dhe vazhdojnë për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh pas njoftimit për rastin që Banka i ka bërë Huamarrësit.

Neni 5 **Hyrja në fuqi, përfundimi**

5.01. Kushtet shtesë për hyrjen në fuqi përbëhen nga sa më poshtë:

a) Banka ka marrë nga Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSH-së, një manual të operacioneve të projektit, që është i pranueshëm për Bankën, dhe Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSH-së, e ka miratuar manualin në fjalë.

b) Banka ka marrë nga Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSH-së, një plan veprimi me afate të përcaktuara kohore, që është i pranueshëm për Bankën, në lidhje me përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësisë të agjencive përkatëse për ligjërimin e pranueshmërisë për përfitimet në bazë të programit të ndihmës ekonomike, të bazuar në llogaritjen automatike të pikëve të vlerësimit, duke përdorur formulën e unifikuar të pikëzimit.

c) Banka ka marrë nga Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSH-së, një plan veprimi me afate të përcaktuara kohore, që është i pranueshëm për Bankën, për zbatimin e aktiviteteve sipas pjesës 2 të projektit.

5.02. Afati për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje është nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së nënshkrimit të saj.

Neni 6 **Përfaqësuesi, adresat**

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i Financave

6.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave

Nr. 1 Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë, Shqipëri

Faks:

+355 42228494



6.03 Adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Adresa kabllore:

Teleks:

Faks:

INTBAFRAD

248423(MCI) ose

1-202-477-6391

Washington, D.C.

64145(MCI)

Rënë dakord në _____, _____, në datën dhe vitin e shkruar në fillim.

SHQIPËRIA

Nga _____

Përfaqësues i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga _____

Përfaqësues i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

**PROGRAMI 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**

Objekti i projektit është të mbështesë zbatimin e reformave nga ana e Huamarrësit për përmirësimin e barazisë dhe efikasitetit të programeve të tij të ndihmës sociale.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Forcimi i zbatimit dhe performancës së programeve të asistencës sociale

Mbështetja e zbatimit të përmirësuar si e programit të ndihmës ekonomike edhe e programit të aftësisë së kufizuar nëpërmjet dhënies së financimit për rimbursimin e pagesave që Huamarrësi ka bërë nga alokimet e tij buxhetore për programin e ndihmës ekonomike (pagesat për programin e miratuar të shpenzimeve).

Pjesa 2: Asistenca teknike për forcimin e kapacitetit zbatues për programet e ndihmës sociale

Realizimi i aktiviteteve të mëposhtme për forcimin e kapacitetit të Huamarrësit për zbatimin e përmirësimeve në dhënie e përfitimeve të ndihmës sociale:

a) Dhënia e asistencës teknike për rishikimin e parametrave të programeve të ndihmës sociale, duke përfshirë: rishikimin e kriterëve të vlerësimit për ndihmën e aftësisë së kufizuar; përfshirjen e përvojës ndërkombëtare; rishikimin e procedurave të biznesit dhe marrëveshjeve institucionale; dhe përditësimin e formulës së unifikuar të pikëzimit (e cila ndihmon në përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë së familjeve për përfitim të ndihmës ekonomike).

b) Dhënia e asistencës teknike për mbështetjen e zhvillimit të një sistemi të informacionit për menaxhimin, duke përfshirë: rishikimin e procedurave thelbësore të biznesit, rolet institucionale dhe kërkesat funksionale për të përcaktuar produktet për projektimin e sistemit të informacionit për menaxhimin; zhvillimin e sigurimit të cilësisë për ngritjen dhe zbatimin e sistemit të informacionit për menaxhimin; zhvillimin e një politike të rishikuar të sanksioneve dhe mekanizmave të zbatimit

për të forcuar aftësitë për të zgjidhur ligjërisht mashtrimet dhe gabimet; dhe hartimin e instrumenteve për zbulimin e mashtrimeve dhe gabimeve, dhe mekanizmat e tjerë të inspektimit social.

c) Dhënia e asistencës teknike për promovimin e transparencës në komunikime dhe monitorim dhe vlerësim, duke përfshirë:

i) nxitjen e ndërgjegjësimit, të kuptuarit dhe pranimit të reformave në NE dhe PAK, nëpërmjet hartimit, ndër të tjera, të një strategjie gjithëpërfshirëse komunikimi dhe të mjeteve specifike të komunikimit të përshtatura për temat dhe grupet e synuara specifike; dhe

ii) forcimin e monitorimit dhe të vlerësimit nëpërmjet hartimit dhe zbatimit, ndër të tjera, të një procesi për vlerësimin e reformave në NE dhe PAK dhe zbatimin e një studimi në ndjekje të aftësisë së kufizuar për të mbështetur monitorimin e reformave të ndihmës së aftësisë së kufizuar.

d) Ofrimi i mbështetjes së zbatimit të projektit nëpërmjet financimit të kostove operative dhe dhënies së konsulencës për të përmirësuar ekspertizën teknike të MPCSSH-së në fusha që përfshijnë: menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e përditshëm të projektit, prokurimet dhe menaxhimin financiar.

PROGRAMI 2 ZBATIMI I PROJEKTIT

Seksioni I. Zbatimi

A. Marrëveshjet e zbatimit

1. Huamarrësi: a) mban gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit grupin e punës për koordinimin, të kryesuar nga zëvendësministri i MPCSSH-së dhe duke përfshirë përfaqësues nga MPCSSH-ja, Shërbimi Social Shtetëror dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, grup i cili është përgjegjës për drejtimin e zbatimit të reformave në programet e ndihmës sociale dhe për sigurimin e koordinimit të aktiviteteve në kuadër të projektit ndërmjet të gjitha agjencive dhe enteve përkatëse; dhe b) zgjeron anëtarësimin e grupit për të përfshirë përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Instituti i Statistikave të Shqipërisë.

2. Brenda tre (3) muajve nga data e hyrjes në fuqi, Huamarrësi do të ketë personel shtesë në Drejtorinë e Politikave të Shërbimeve Sociale në MPCSSH, me terma reference të pranueshme për Bankën dhe me ekspertizën e përshkruar më poshtë, dhe do të mbajë, siç kërkohet, personelin në fjalë gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit: ekspertizë në menaxhim, monitorim dhe vlerësim projekti, prokurime dhe menaxhim financiar.

3. Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSH-së, zbaton programin e përgatitur në bazë të dispozitave të paragrafit 5.01(b) të kësaj marrëveshjeje dhe të pranuar nga Banka.

4. Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSH-së, zbaton programin e përgatitur në bazë të dispozitave të paragrafit 5.01(c) të kësaj marrëveshjeje dhe të pranuar nga Banka.

5. Huamarrësi garanton që gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit, fondet e nevojshme buxhetore të vihen çdo vit në dispozicion për qëllimet e zbatimit të projektit.

6. Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSH-së, zbaton projektin në përputhje me manualin operacional të projektit dhe nuk ndryshon, shtyn zbatimin, ndërpret, pezullon dhe/ose shfuqizon manualin operacional të projektit, qoftë në tërësi apo pjesërisht, pa marrëveshjen paraprake të Bankës.

B. Antikorrupsioni

Huamarrësi garanton që projekti zbatohet në përputhje me dispozitat e udhëzimeve të antikorrupsionit.

Seksioni II. Raportimi, monitorimi dhe vlerësimi i projektit

A. Raportet e projektit



1. Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSH-së, monitoron dhe vlerëson progresin e projektit dhe përgatit raportet e projektit në përputhje me dispozitat e paragrafit 5.08 të kushteve të përgjithshme dhe mbi bazën e treguesve të pranueshëm për Bankën. Çdo raport i projektit mbulon periudhën e një semestri kalendarik, dhe i dorëzohet Bankës jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

2. Gjatë zbatimit të projektit, Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSH-së, do të kryejë inspektime tematike të bazuara në modele për zbatimin e ndihmës ekonomike, në bazë të atij objekti dhe rregullsisë, siç përcaktohet në manualin operacional të projektit dhe duke mbuluar pa kufizim, nivelin e parregullsisë dhe gabimeve që ndodhin në administrimin e përfitimeve sociale, shkaqet e tyre dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra. Raportet e inspektimeve tematike i vihen në dispozicion për shqyrtim Bankës dhe Huamarrësit, nëpërmjet MPCSSH-së, dhe Bankës i jepet mundësia për të diskutuar dhe për të bërë komente mbi raportet në fjalë. Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSH-së, zbaton menjëherë çdo rekomandim të miratuar që jepet nga Banka në bazë të këtyre vlerësimeve.

B. Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe auditimet

1. Huamarrësi mban ose merr masa për mbajtjen e një sistem menaxhimi financiar në përputhje me dispozitat e paragrafit 5.09 të kushteve të përgjithshme.

2. Pa kufizime ndaj dispozitave të pjesës A të këtij paragrafi, Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSH-së, përgatit dhe i dorëzon Bankës jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas fundit të çdo tremujori kalendarik, raporte financiare të ndërmjetme të paaudituar për projektin, duke mbuluar tremujorin, në atë formë dhe përmbajtje që është e pranueshme për Bankën.

3. Huamarrësi auditon pasqyrat financiare që lidhen me projektin në përputhje me dispozitat e paragrafit 5.09 (b) të kushteve të përgjithshme. Çdo auditim i pasqyrave financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të Huamarrësit. Pasqyrat financiare të audituara për secilën nga këto periudha: i) i dorëzohet Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të kësaj periudhe; dhe ii) vihen në dispozicion të publikut në një kohë dhe mënyrë që është e pranueshme për Bankën.

Seksioni III. Prokurimet

A. Të përgjithshme

1. Mallrat. Të gjitha mallrat që nevojiten për pjesën 2 të këtij projekti dhe që do të financohen nga të ardhurat e huas prokurohen në përputhje me kërkesat që përcaktohen apo që referohen në seksionin I të udhëzimeve të prokurimeve dhe me dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve që nevojiten për pjesën 2 të këtij projekti dhe që do të financohen nga të ardhurat e huas, prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të referuara në seksionet I dhe IV të udhëzimeve të konsulentëve dhe me dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizimet. Shprehjet me germa kapitale të përdorura më poshtë në këtë seksion, për të përshkruar metoda të veçanta prokurimi ose metoda rishikimi të kontratave të veçanta nga ana e Bankës, i referohen metodës përkatëse të përshkruar në seksionet II dhe III të udhëzimeve të prokurimit ose seksioneve II, III, IV dhe V të udhëzimeve të konsulentëve, sipas rastit.

B. Metoda të veçanta të prokurimit të mallrave

1. Tenderimi konkurrues ndërkombëtar. Përveçse në rastet kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat prokurohen nëpërmjet kontratave që bëhen mbi bazën e procedurave të tenderimit konkurrues ndërkombëtar.

2. Metoda të tjera të prokurimit të mallrave. Metoda e mëposhtme, përveç metodës së tenderimit konkurrues ndërkombëtar, mund të përdoret për prokurimin e mallrave për ato kontrata të përcaktuara në programin e prokurimit, d.m.th. blerje.

C. Metoda të veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

1. Përzgjedhja mbi bazën e cilësisë dhe koston. Përveçse në rastet kur parashikohet ndryshe nga paragrafi 2 i mëposhtëm, shërbimet e konsulentëve prokurohen nëpërmjet kontratave të dhëna bazuar në përzgjedhjen mbi bazën e cilësisë dhe koston.

2. Metoda të tjera të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve. Metodat e mëposhtme, përveç asaj që bazohet mbi përzgjedhjen mbi bazën e cilësisë dhe koston, mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato kontrata, të cilat janë specifikuar në planin e prokurimit: a) Përzgjedhje mbi bazën e cilësisë; b) Përzgjedhje në kuadër të një buxheti fiks; c) Përzgjedhje e koston më të ulët; d) Përzgjedhje e bazuar mbi kualifikimin e konsulentëve; e) Përzgjedhje e një burimi të vetëm e firmave të konsulencës; f) Procedurat e përcaktuara në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të udhëzimeve të konsulentëve për përzgjedhjen e konsulentëve individualë; dhe g) Procedura me burim të vetëm për përzgjedhjen e konsulentëve individualë.

D. Shqyrtimi nga Banka i vendimeve të prokurimit

1. Në lidhje me pjesën 2 të projektit, plani i prokurimit parashikon ato kontrata të financuara nga të ardhurat e huas, të cilat i nënshtrohen shqyrtimit paraprak të Bankës. Të gjitha kontratat e tjera i nënshtrohen shqyrtimit të mëvonshëm nga Banka.

2. Në lidhje me kontratat për zbatimin e projektit që do të financohen nga Huamarrësi, termat teknikë të referencës të këtyre kontratave i nënshtrohen miratimit paraprak të Bankës.

Seksioni IV. Tërheqja e të ardhurave të huas

A. Të përgjithshme

1. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e huas në përputhje me dispozitat e nenit II të kushteve të përgjithshme, këtij seksioni, dhe atyre udhëzimeve, të cilat mund të specifikohen nga Banka me njoftim për Huamarrësin (duke përfshirë “Udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimin për projektet” maj 2006, që është rishikuar herë pas here nga Banka dhe që zbatohet për këtë marrëveshje bazuar në këto udhëzime), për të financuar shpenzimet e miratuara që përcaktohen në tabelën e dhënë në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e shpenzimeve të miratuara, të cilat mund të financohen nga të ardhurat e huas (kategoria), alokimet e shumave të huas për secilën kategori dhe përqindja e shpenzimeve që duhet të financohet për shpenzimet e miratuara në secilën kategori:

Kategoria	Shuma e huas së alokuar (shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve për t'u financiar
1. Pagesa për programin e shpenzimeve të miratuara në kuadër të pjesës 1 të projektit	36,765,000	Shuma e treguesve të lidhur me disbursimin e përcaktuar në shtojcën e programit 2 të kësaj marrëveshjeje
2. Shërbimet e konsulentëve në kuadër të pjesës 2 të projektit dhe kostot operative	1,140,000	100%
3. Tarifa fillestare	95,000	Shuma e pagueshme në bazë të seksionit 2.03 të kësaj marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07 (b) të kushteve të përgjithshme
SHUMA TOTALE	38,000,000	

B. Kushtet e tërheqjes, periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, asnjë tërheqje nuk do të bëhet:

a) për pagesa të bëra para datës së kësaj marrëveshjeje; dhe

b) për pagesat në kategorinë (1) në lidhje me secilën shumë të treguesve të lidhur me



disbursimin - DLI të përcaktuar në shtojcën 2 të kësaj marrëveshjeje dhe për të cilat është dorëzuar një kërkesë tërheqjeje, përveçse kur Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSHB-së, ka ofruar evidenca të pranueshme nga Banka që:

i) Pagesat për programin e miratuar të shpenzimeve janë bërë për përfituesit e miratuar nga Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSHB-së, në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjet në fuqi të Huamarrësit dhe manualin operacional të projektit; dhe

ii) dispozitat e paragrafit 2 të mëposhtëm janë plotësuar.

2. Pa kufizime për dispozitën e përcaktuar në paragrafin 1 të seksionit IV.B të këtij programi, tërheqjet nga Huamarrësi në kuadër të kategorisë (1) do të bëhen në shtatëmbëdhjetë (17) transe dhe secili transh do të jetë në shumën e specifikuar në kolonën “shuma e treguesve të lidhur me disbursimin - DLI” në tabelën e shtojcës së programit 2 të kësaj marrëveshjeje, në varësi të dorëzimit në Bankë të evidencave të pranueshme për Bankën dhe siç përcaktohet në manualin operacional të projektit që:

a) Indeksi i inflacionit për përfitimet e PAK ka vazhduar të zbatohet që në vitin 2010 dhe se çdo rritje në përfitime nuk e kalon një indeksim të tillë (kushti global i disbursimit); dhe

b) Treguesit e lidhur me disbursimin - DLI të përcaktuar në shtojcën e programit 2 të kësaj marrëveshjeje (dhe për të cilën është dorëzuar një kërkesë për tërheqje) është arritur.

3. Pavarësisht nga sa më sipër:

a) Nëse Banka nuk është e kënaqur me plotësimin e kushtit global të disbursimeve dhe ka mbajtur disbursimin e të ardhurave të huas në kuadër të kategorisë (1) në lidhje me çdo tregues të lidhur me disbursimin - DLI që është arritur, Banka në bazë të gjykimit të saj:

i) mund të autorizojë në një datë të mëvonshme kur Banka është e kënaqur me plotësimin e kushtit global të disbursimeve, tërheqjen e të ardhurave të huas të mbajtura në lidhje me treguesin e lidhur me disbursimin - DLI që është plotësuar; ose

ii) mund të anulojë në çdo kohë, duke njoftuar Huamarrësin, shumën e të ardhurave të huas të mbajtura ose ta rialokojë shumën në fjalë për tregues të tjerë të lidhur me disbursimin - DLI.

b) Nëse Banka vendos, në çdo kohë, që ndonjë pjesë e shumave të disbursuara nga Huamarrësi në kategorinë (1) është përdorur për rimbursimin e shpenzimeve që nuk janë të pranueshme në kuadër të pagesave për programin e miratuar të shpenzimeve apo jo në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1(b) dhe 2 të seksionit IV.B të këtij programi, Huamarrësi do t'i rikthejë menjëherë çdo shumë të tillë Bankës, ashtu si Banka do të specifikojë në njoftimin për Huamarrësin.

4. Data e mbylljes është 30 qershor 2017.

SHTOJCA E PROGRAMIT 2
TREGUESIT QË LIDHEN ME DISBURSIMET DHE SHUMA E TREGUESVE TË
LIDHUR ME DISBURSIMIN - DLI

Numri	Treguesi që lidhet me disbursimet (DLI)	Shuma e DLI (shprehur në euro)
1	Të paktën 90 për qind e administratorëve socialë në tri rajonet pilote janë trajnuar rreth zbatimit të formulës së unifikuar të pikëzimit për programin e ndihmës ekonomike	1,045,000
2	Të paktën 80 për qind e familjeve në tri rajonet pilote, të cilat marrin përfitime për programin e NE janë kontrolluar për pranueshmërinë e tyre, duke përdorur formulën e unifikuar të pikëzimit për të cilën është rënë dakord me Bankën	1,900,000
3	Të paktën 80 për qind e dosjeve të kërkuesve të NE në tri rajonet pilote janë plotësuar dhe në përputhje me proceset e aplikimit dhe	

	hyrjes, duke përdorur formulën e unifikuar të pikëzimit, të specifikuar në udhëzimet operacionale të NE për të cilat është rënë dakord me Bankën	1,900,000
4	Të paktën 80 për qind e familjeve në nivel kombëtar, të cilat po marrin përfitimet për programin e NE janë kontrolluar për pranueshmërinë e tyre duke përdorur formulën e unifikuar të pikëzimit për të cilën është rënë dakord me Bankën	1,900,000
5	Kritere vlerësimi, procedura biznesi dhe marrëveshje institucionale të rishikuara për PAK bazuar në modelin social janë hartuar dhe paratestuar	1,900,000
6	Kriteret e vlerësimit, procedurat e biznesit dhe marrëveshjet institucionale për PAK janë rishikuar bazuar në modelin social dhe këto rishikime janë konsultuar, miratuar dhe shpërndarë	1,900,000
7	Të paktën dy të tretat e përfituesve ekzistues të PAK, të cilët janë subjekt i një ricertifikimi vjetor, janë rivlerësuar duke përdorur kriteret dhe proceset e rishikuara bazuar në modelin social	1,900,000
8	Faza e parë e MIS NE është zhvilluar dhe testuar, duke përfshirë modulet funksionale për një regjistër kombëtar për aplikantët në NE, zgjedhjen e familjeve, futjen në program, nxjerrja e urdhrit të pagesës dhe raportimin	2,090,000
9	Të paktën 90 për qind e njërive të pushtetit vendor (bashki/komuna) në tri rajonet pilote përdorin MIS për të përpunuar regjistrimin e aplikantëve, përzgjedhjen e përfituesve, hyrjen në program dhe urdhërpagesat e NE	2,850,000
10	Informacioni familjar dhe/ose individual i regjistruar për përfituesit në MIS NE është kontrolluar në mënyrë të kryqëzuar me informacionin përkatës në të paktën 3 sisteme qeveritare të informacionit (siç janë regjistri i taksave, punësimi, qarkullimi rrugor, gjendja civile, regjistrimi i bizneseve apo sistemi i pensioneve)	2,850,000
11	Të paktën 90 për qind e njërive të pushtetit vendor (bashki/komuna) në nivel kombëtar përdorin MIS NE për të përpunuar regjistrimin e aplikantëve, përzgjedhjen e përfituesve, hyrjen në program dhe urdhërpagesat e NE; dhe MIS NE është zgjeruar për të mbuluar funksionet e fazës së dytë, duke përfshirë një modul të informacionit të biznesit për monitorim dhe vlerësim	2,850,000
12	Faza e tretë e MIS NE është zhvilluar dhe testuar, me funksione të zgjeruara që përfshijnë një modul “për menaxhim të integruar të rasteve” dhe një lidhje me sistemin e thesarit për të mundësuar përputhjen e pagesave elektronike të automatizuara	2,090,000
13	Faza e parë e MIS PAK është zhvilluar dhe testuar, duke përfshirë module funksionale për një regjistër kombëtar të aplikantëve të rinj dhe përfituesit ekzistues të PAK, vlerësimi i për pranueshmërisë së tyre, ricertifikimi, futja në program, nxjerrja e urdhërpagesave dhe raportimin	2,090,000
14	Të paktën 90 për qind e njërive të pushtetit vendor (bashki/komuna) në 2 rajonet pilote, të përzgjedhura në konsultim me Bankën, përdorin MIS PAK të automatizuar për të përpunuar regjistrimin e	



	aplikantëve të rinj të PAK dhe futjen në program; për regjistrimin e vendimeve të ricertifikimit për përfituesit ekzistues; dhe për nxjerrjen e urdhërpagesave për përfituesit e rinj dhe ata ekzistues	2,850,000
15	Të paktën 90 për qind e njërive të pushtetit vendor (bashki/komuna) në nivel kombëtar përdorin MIS PAK të automatizuar për të përpunuar regjistrimin e aplikantëve të rinj të PAK dhe futjen në program; për regjistrimin e vendimeve të ricertifikimit për përfituesit ekzistues; dhe për nxjerrjen e urdhërpagesave për përfituesit e rinj dhe ata ekzistues; dhe MIS PAK është zgjeruar për të përfshirë funksione të fazës së dytë, përfshirë integrimin e të dhënave nga vlerësimi i rishikuar i pranueshmërisë së tyre bazuar në modelin social	2,850,000
16	Të paktën 75% e rasteve të dyshuara për mashtrim dhe gabime në NE dhe PAK janë hetuar nga inspektorët sociale në përputhje me politikën dhe legjislacionin e rishikuar të sanksioneve	1,900,000
17	Është zbatuar profilizimi me bazë riskun për zbulimin e gabimeve dhe mashtrimin në NE dhe PAK	1,900,000

PROGRAMI 3 GRAFIKU I AMORTIZIMIT

1. Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të huas dhe përqindjet e shumës totale të principalit të huas të pagueshme në secilën datë të pagesës së principalit (përqindja e këstit). Nëse të ardhurat nga huaja janë tërhequr plotësisht deri në datën e parë të pagesës së principalit, shuma e principalit të huas e shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë të pagesës së principalit do të përcaktohet nga Banka duke shumëzuar: a) Bilancin e huas së tërhequr deri në datën e parë të pagesës së principalit; me b) Përqindjen e këstit për secilën datë të pagesës së principalit, kjo shumë e shlyeshme të ndryshohet, sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë të referuar në paragrafin 4 të këtij programi, për të cilën zbatohet një konvertim monedhe.

Data e pagesës së principalit	Përqindja e këstit (shprehur si %)
Çdo 15 mars dhe 15 shtator	
Duke filluar në 15 shtator 2019 deri në 15 shtator 2039	2.38%
Në 15 mars 2040	2.42%

2. Nëse të ardhurat e huas nuk janë tërhequr plotësisht deri në datën e parë të pagesës së principalit, atëherë shuma e principalit të huas e shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë të pagimit të principalit do të përcaktohet si më poshtë:

a) Deri në masën që çdo e ardhur e huas është tërhequr deri në datën e parë të pagesës së principalit, Huamarrësi do të shlyejë balancën e huas së tërhequr deri në atë datë në përputhje me paragrafin 1 të këtij programi.

b) Çdo shumë e tërhequr pas datës së parë të pagesës së principalit do të shlyhet në çdo datë të pagesës së principalit që bie pas datës së kësaj tërheqjeje në shumën e përcaktuar nga Banka, duke shumëzuar shumën e secilës nga këto tërheqje me një thyesë, numëruesi i së cilës është përqindja fillestare e këstit të specifikuar në tabelën në paragrafin 1 të këtij programi për datën e pagesës së principalit në fjalë (përqindja fillestare e këstit) dhe emëruesi i së cilës është shuma e të gjithë përqindjeve fillestare të këstit të mbetur për datat e pagesës së principalit që bien në këtë datë ose pas kësaj date, shuma të shlyeshme, të cilat do të rregullohen, sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë të referuar në paragrafin 4 të këtij programi, për të cilat zbatohet një konvertim monedhe.

3. a) Shumat e huas të tërhequra brenda dy muajve kalendarikë përpara çdo date të pagesës së principalit do të trajtohen, vetëm për qëllimin e përlllogaritjes së shumave të principalit të pagueshme në çdo datë të pagesës së principalit, si të tërhequra dhe të papaguara në datën e dytë të pagesës së principalit që bie pas datës së tërheqjes dhe do të jenë të shlyeshme në secilën datë të pagesës së principalit, duke filluar nga data e dytë e pagesës së principalit që bie pas datës së tërheqjes.

b) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit (a) të këtij paragrafi, nëse në çdo moment Banka fut një sistem të faturimit në datën e kërkuar sipas të cilit faturat lëshohen në ditën e ose pas datës përkatëse të pagesës së principalit, dispozitat e këtij nënparagrafi nuk do të jenë më të zbatueshme për tërheqjet e bëra pas miratimit të këtij sistemi faturimi.

4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij programi, pas një konvertimi monedhe për të gjithë ose ndonjë pjesë të bilancit të huas së tërhequr në një monedhë të miratuar, shuma e konvertuar në këtë mënyrë në monedhën e miratuar, e cila është e pagueshme në çdo datë të pagesës së principalit që ndodh gjatë periudhës së konvertimit, do të përcaktohet nga Banka duke shumëzuar këtë shumë në monedhën e emërimit të saj menjëherë përpara konvertimit ose me: i) kursin e këmbimit që pasqyron shumat e principalit në monedhën e miratuar të pagueshme nga Banka sipas transaksionit kufizues të riskut të investimit të monedhës që lidhet me konvertimin; ose ii) nëse Banka vendos në këtë mënyrë në përputhje me udhëzimet e konvertimit, me komponentin e kursit të këmbimit të normës së kontrollit.

5. Nëse bilanci i huas së tërhequr është shprehur në më shumë se një monedhë huaje, dispozitat e këtij programi do të zbatohen veçmas për shumën e emërtuar në secilën monedhë huaje, në mënyrë që të përgatitet një grafik i veçantë amortizimi për secilën nga këto shuma.

SHTOJCA PËRKUFIZIME

1. “Udhëzimet antikorrupsion” nënkupton “Udhëzime për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit te projektet e financuara me hua dhe grante nga IBRD-ja dhe IDA”, të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuara në janar 2011.

2. “Kategori” nënkupton një kategori të përcaktuar sipas tabelës në seksionin IV të programit 2 të kësaj marrëveshjeje.

3. “Udhëzimet për konsulentët” nënkupton “Udhëzimet: përzgjedhja dhe pajtimi i konsulentëve sipas huas së IBRD-së dhe huave e granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, të muajit janar 2011.

4. “Shuma e treguesve që lidhen me disbursimet (DLI)” nënkupton shumën e huas së përcaktuar në kolonën me titull “shuma e DLI-së” sipas tabelës së ndodhur në shtojcën e programit 2 të kësaj marrëveshjeje.

5. “Programi i ndihmës për aftësinë e kufizuar” dhe “PAK” nënkuptojnë programin e huamarrësit në lidhje me pagesën e përfitimeve për personat me aftësi të kufizuar, siç përcaktohen dhe parashtrihen në legjislacionet e ndryshme, përfshirë ligjin nr. 8098 të datës 28 mars 1996 “Mbi statusin e personave të verbër” dhe ligjin nr. 8626 të datës 22 qershor 2000 “Për statusin e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, si dhe vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave të Huamarrësit për përfitimet që rrjedhin nga statusi i personave të verbër dhe nga statusi i invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

6. “Treguesit që lidhen me disbursimet” dhe “DLI-të”, të marra bashkërisht, nënkuptojnë objektivat që lidhen me disbursimet e parashtruara, sipas kolonës së titulluar “tregues që lidhen me disbursimet (DLI)” të parashtruara në tabelë në shtojcën e programit 2 të kësaj marrëveshjeje; si dhe termat “Treguesit që lidhen me disbursimet” dhe “DLI” nënkuptojnë individualisht çdonjërin prej



këtyre objektivave.

7. “Kushtet e përgjithshme” nënkuptojnë “kushtet e përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huat”, të datës 31 korrik 2010.

8. “Kushti global i disbursimeve” nënkupton kushtin e disbursimeve të përcaktuara në paragrafin 2 (a) të seksionit IV. B të programit 2 të kësaj marrëveshjeje.

9. “MIS” nënkupton sistemin e menaxhimit të informacionit.

10. “MPCSSH” nënkupton Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të Huamarrësit apo çdo pasuesi tjetër të saj.

11. “Programi i ndihmës ekonomike” dhe “NE”, nënkuptojnë programin e asistencës sociale të përfuturit para në dorë/në të holla, të krijuar sipas ligjit nr. 9355 të datës 10 mars 2005, i ndryshuar në prill 2011.

12. Termi “kosto operative” nënkupton shpenzimet e arsyeshme rritëse të administratës së MPCSSH-së në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të projektit, përfshirë mirëmbajtjen, pajisjet e zyrave, orenditë, materialet e pajisjet, si dhe mjetet e komunikimit.

13. “Pagesat për programin e miratuar të shpenzimeve” nënkupton pagesat e përfitimeve që huamarrësi ka kryer me alokimet buxhetore të tij për programin e ndihmës ekonomike.

14. “Udhëzimet e prokurimeve” nënkupton “Udhëzimet: Prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimet jokonsultative sipas huas së IBRD-së dhe huas e granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, të muajit janar 2011.

15. “Plani i prokurimeve” nënkupton planin e prokurimeve të Huamarrësit për projektin, të datës 13 shkurt 2012, të referuar në paragrafin 1.18 të udhëzimeve të prokurimeve dhe në paragrafin 1.25 të udhëzimeve për konsulentët, i cili do të përditësohet herë pas here sipas dispozitave të paragrafëve të lartpërmendur.

16. “Manuali operacional i projektit” dhe “MOP” nënkuptojnë manualin e aktiviteteve të projektit, që duhet të përgatitet nga Huamarrësi, nëpërmjet MPCSSH-së, në përputhje me termat e referencës të pranueshme për Bankën, duke ofruar, midis të tjerave: a) Organizimin institucional për zbatimin e projektit b) Masat për qarkullimin e fondeve të projektit, përfshirë protokollet dhe udhëzimet për menaxhimin financiar të projektit, përgatitjen e aplikimeve të tërheqjes së fondeve, mbajtjen e të dhënave, auditimin, raportimin dhe kontrollet e brendshme; c) Udhëzimet për planifikimin dhe ekzekutimin e aktiviteteve të prokurimeve sipas pjesës 2 të projektit; d) Protokollin për paraqitjen e evidencave të dokumentuara në përputhje me arritjen e DLI-ve; dhe d) Politikat dhe procedurat për monitorimin e aktiviteteve të projektit, si dhe plotësimin e kërkesave të raportimit të tyre për t’u miratuar nga Huamarrësi sipas nenit 5.01 (a) të kësaj marrëveshjeje.

17. “Modeli social” nënkupton një model që përfshin vlerësimin mjekësor dhe jomjekësor të kapaciteteve dhe nevojave funksionale.

18. “Tri rajonet pilote”, të marra së bashku, nënkupton rajonet e Durrësit, Elbasanit dhe Tiranës.

19. “Formula e unifikuar e pikëzimit” nënkupton një formulë të pranueshmërisë së familjeve për (ndihmë ekonomike), duke përdorur koeficientë dhe ndryshore të përcaktuara qartë, të cilët dalin nga korelacionet objektive me statusin ekonomik dhe me varfërinë.

LIGJ
Nr. 85/2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9049, DATË 10.4.2003 “PËR
DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË
TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, pas pikës 6 shtohen pikat 7, 8 e 9 me këtë përmbajtje:

“7. “Shpenzim i deklarueshëm” është tërësia monetare, e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, aredim, si dhe të tjera shpenzime të këtij lloji, të kryera nga subjekti deklarues.

8. Termat “konflikt i interesit”, “zyrtar”, “person i lidhur”, “interesa privatë”, të përdorur në këtë ligj, kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në nenin 3 pikat 1, 4, 7 dhe 11, si dhe në nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

9. Përkufizimet “të dhënat personale” dhe “përpunimi i të dhënave” kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.”.

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Subjektet që mbartin detyrimin për deklarim

1. Mbartin detyrimin për deklarim periodik në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive:

a) Presidenti i Republikës, deputetët e Kuvendit, Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministrat e zëvendësministrat;

b) gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;

c) nëpunësit civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues, sipas përcaktimit të nenit 11 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”;



ç) prefektët, nënprefektët, kryetarët e këshillave të qarqeve, kryetarët e bashkive, të njësisve bashkiake dhe të komunave;

d) drejtorët e drejtorive dhe komandantët e Forcave të Armatosura, në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shërbimin Informativ Shtetëror;

dh) prokurorët, gjyqtarët dhe përmbauesit e të gjitha niveleve;

e) drejtuesit e institucioneve të pavarura publike dhe anëtarët e enteve rregullatore;

ë) drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive dhe shefat e sektorëve, (komisariateve) në qendër, rrethe e rajone, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe nivelet drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;

f) zyrtari i administratës doganore dhe tatimore, që merret me mbledhjen e të ardhurave doganore ose tatimore, përfshirë zyrtarin tatimor të njësisve të qeverisjes vendore;

g) drejtuesit e të gjitha niveleve të strukturave të kthimit e kompensimit të pronave, të privatizimit dhe regjistrimit të pasurisë;

gj) zyrtarët, që zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi, Presidenti i Republikës, Kryeministri, ministrat ose personat e barazuar me ta;

h) Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, zëvendësguvernatori dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj;

i) drejtuesit e institucioneve publike në varësi të institucioneve qendrore, në nivel qarku;

j) drejtuesit e shoqërive anonime me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind dhe me më shumë se 50 punëtorë.

2. Mbartin detyrimin për deklarim edhe personat që, sipas nenit 9 të këtij ligji, mbartin detyrimin e deklarimit me kërkesë.

3. Kuvendi, me vendim të tij dhe me propozim të Inspektorit të Përgjithshëm, vendos detyrimin për deklarim të pasurisë për funksione të tjera, të paparashikuara në këtë ligj.”.

Neni 3

Në nenin 4 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në paragrafin e parë, fjala “pasurive” zëvendësohet me fjalët “interesave privatë”.

2. Në shkronjën “c”, fjalët “5 000 dollarë amerikanë” zëvendësohen me fjalët “500 000 (pesëqind mijë) lekë”.

3. Pas shkronjës “ë” shtohen shkronjat “f”, “g”, “gj” dhe “h” me këtë përmbajtje:

“f) dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtim preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi;

g) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose ky angazhim;

gj) interesa privatë të subjektit, që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës;

h) çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 500 000 (pesëqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit.”.

4. Në fund të nenit 4 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Interesat privatë të llojeve të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji mund të kërkohen të deklarohen periodikisht, nëse kjo është e mundur dhe e përshtatshme për nënloje interesash brenda këtyre llojeve, të përcaktuara me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm.”.

Neni 4

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1

Deklarimi para fillimit të punës

1. Të gjitha subjektet, që mbartin detyrimin për deklaram, sipas këtij ligji, duhet të deklarojnë para fillimit të punës:

a) të gjitha pasuritë e grumbulluara, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji, përfshirë burimet e krijimit të tyre;

b) angazhimet në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, që ekzistojnë në datën e fillimit të punës, përfshirë çdo lloj të ardhure të krijuar nga këto angazhime ose veprimtari, nga data 1 janar deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklaramit.

2. Deklarimi para fillimit të punës dorëzohet jo më vonë se 30 ditë nga data e fillimit të detyrës.”.

Neni 5

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Deklarimi periodik vjetor

1. Në deklaramin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë, të deklaram me parë, sipas nenit 6 të këtij ligji, ata të lindur gjatë vitit që deklaram dhe çdo e ardhur e fituar dhe shpenzim i deklarameshëm, i kryer gjatë gjithë vitit për të cilin bëhet deklarami.

2. Deklarimi para fillimit të punës, sipas nenit 6, dhe ai pas largimit nga funksioni, sipas nenit 8 të këtij ligji, janë raste të veçanta të deklaramit periodik.

3. Të gjithë zyrtarët dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrim për deklaram, detyrohen të paraqesin deklaramtën e tyre, të mbyllur në zarf, deri më 31 mars të çdo viti, pranë autoritetit ose strukturës përgjegjëse të institucionit publik, të parashikuar në shkronjën “b” të pikës 2 të nenit 41 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

4. Kur zyrtari transferon të drejtat e zotërimit aktiv të aksioneve ose të pjesëve në kapital, sipas pikës 3 të nenit 38 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, në deklaramin periodik, për sa kohë vazhdon kjo gjendje, ai deklaron vetëm gjendjen e këtyre të drejtave para transferimit dhe frytet e pasurisë, të cilat ai ka marrë efektiviisht gjatë vitit për të cilin bëhet deklarami.

5. Për qëllim të deklaramit periodik vjetor, sipas pikave të mësipërme të këtij neni, ndër personat e lidhur me zyrtarin, mbartin detyrim për deklaram vetëm bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë.”.

Neni 6

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:



“Neni 7/1

Deklarimi pas largimit nga funksioni

1. Deklarimi pas largimit nga funksioni kryhet vetëm një herë për periudhën nga deklarimi i fundit deri në datën e largimit, me përjashtim të rastit kur zyrtari fillon punë në një detyrë tjetër, që, sipas këtij ligji, vazhdon të mbartë detyrimin për deklaram.

2. Në deklaramin pas largimit nga funksioni jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë, për periudhën nga deklarimi i fundit deri në datën e largimit nga funksioni.

3. Deklarimi kryhet jo më vonë se 15 ditë nga data e largimit nga funksioni.”.

Neni 7

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Deklarimi me kërkesë

1. Inspektori i Përgjithshëm ka detyrimin të kërkojë deklaramin e pasurive e të interesave privatë dhe burimet e krijimit të tyre, sipas kërkesave të këtij ligji, si dhe të urdhërojë kontrollin për saktësinë e këtyre deklarameve edhe për individët ose personat fizikë e juridikë, kur, nga verifikimet e kryera, rezulton se këta të fundit janë persona të lidhur me subjektet që mbartin detyrimin për deklaram periodik.

2. Vlerësohet person i lidhur, në zbatim të pikës 1 të këtij neni, edhe i besuari, sipas kuptimit të neneve 3 pika 6 dhe 38 pika 3 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, si dhe bashkëjetuesi, sipas kuptimit të neneve 163 e 164 të ligjit nr. 9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”.

3. Inspektori i Përgjithshëm, për efekt të verifikimit të deklaramit të të ardhurave, në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, i dërgon Ministrin të Financave dhe Drejtorin të Përgjithshëm të Tatimeve informacion për listën e individëve, të cilët kanë rezultuar persona të lidhur me subjektet deklaramese që mbartin detyrim për deklaram, sipas pikës 1 të këtij neni.”.

Neni 8

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 9/1

Autorizimi i kontrollit

Deklarimi i pasurisë dhe i interesave privatë shoqërohet me një autorizim të veçantë, ku deklaramesi autorizon organet e përcaktuara në këtë ligj të verifikojnë të gjitha subjektet, private e publike, brenda dhe jashtë vendit, për të dhënat e deklaramës.

Mosdhënia e autorizimit brenda 15 ditëve nga mbarimi i afatit për deklaram përbën shkak ligjor për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, sipas legjislacionit përkatës.”.

Neni 9

Në nenin 11 bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 2 shtohen fjalët “me të drejtë rizgjedhjeje”.

b) Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Pas përfundimit të mandatit, me pëlqimin e tij, ai ka të drejtë të emërohet në funksionin ose detyrën publike që kishte para zgjedhjes së tij ose në një vend të barasvlershëm me vendin e mëparshëm. Ai nuk përfiton nga kjo e drejtë, në rastet kur shkarkohet për shkelje të rëndë të ligjit ose për akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Inspektorit të Përgjithshëm.”.

Neni 10

Në nenin 17, në fund të shkronjës “b” shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Mbledhja e të dhënave bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.”.

Neni 11

Në fund të nenit 22 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Anëtari i familjes dhe personi i lidhur me subjektin deklarues mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara.”.

Neni 12

Pas nenit 25 shtohen nenet 25/1 dhe 25/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/1

Kontrolli i plotë i deklaratës së pasurive dhe interesave privatë

1. Kontrolli i plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave privatë kryhet:

a) çdo 2 vjet për Presidentin e Republikës, Kryeministrin, Zëvendëskryeministrin, ministrin, zëvendësministrin, gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurorin e Përgjithshëm, Avokatin e Popullit, anëtarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtarin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, anëtarin e organeve rregullatore ose të mbrojtjes së konkurrencës, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, zëvendësguvernatorin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj;

b) çdo 3 vjet për deputetët, prefektët, kryetarët e bashkive, komunës dhe këshillit të qarkut (vetëm për kryetarët e bashkive ose të komunave me mbi 10 000 banorë), nëpunësin civil të nivelit të lartë drejtues të administratës publike, zyrtarët e nivelit të lartë drejtues të administratës doganore dhe tatimore, gjyqtarët e apelit, prokurorët e apelit dhe të Prokurorisë së Përgjithshme;

c) çdo 4 vjet për titullarët e institucioneve shtetërore, qendrore ose vendore, dhe anëtarët e organeve kolegjiale të këtyre institucioneve, të papërfshira në shkronjat e mësipërme të kësaj pike.

2. Për të gjitha kategoritë e tjera të zyrtarëve, që i nënshtrohen deklaramit periodik (përfshirë ato të përcaktuara në shkronjat e mësipërme të pikës 1), kontrolli kryhet çdo vit për një numër prej të paktën 4 për qind të numrit të përgjithshëm të deklaratave. Përcaktimi i nivelit të përqindjes për çdo grup funksionesh, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, bëhet nga Inspektori i Përgjithshëm, bazuar në vlerësimin e riskut dhe numrin e zyrtarëve për çdo grup.



Përzgjedhja e deklaratave bëhet me short, në prani të medias, të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të sindikatave. Përzgjedhja e një zyrtari/deklarate, në një vit, nuk e përjashton zyrtarin/deklaratën nga shorti për vitin pasardhës.

3. Për rastet e përcaktuara në pikat 1 shkronjat “a”, “b” e “c” dhe 2 të këtij neni duhet të shmanget kryerja e dyfishtë e kontrollit mbi të njëjtën deklaratë të të njëjtit zyrtar, të bërë në të njëjtin vit, përjashtuar rastet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.

4. Kontrolli ose rikontrolli i plotë i deklarimit kryhet çdo herë që gjykohet e nevojshme nga Inspektori i Përgjithshëm, kur ai ka të dhëna, nga burime të ligjshme, që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në deklarimin e një zyrtari, si dhe kur ka mospërputhje, që rezultojnë nga kontrolli aritmetik e logjik, të cilat tregojnë se burimet nuk mbulojnë ose nuk justifikojnë të drejtat pasurore të deklaruesit.

Neni 25/2

Hetimi administrativ

1. Kur nga rezultatet e verifikimit të deklarimit rezulton se burimet nuk mbulojnë apo justifikojnë pasuritë ose kur për një deklaratë, pavarësisht nëse ka kaluar apo jo në kontroll të plotë, ka të dhëna, nga burime të ligjshme, për fshehje të interesave dhe të çdo të dhëne tjetër private, që është e detyrueshme të deklarohet, ose deklarime të rreme, Inspektori i Përgjithshëm nis hetimin administrativ.

2. Mbledhja e të dhënave, kryerja e kontrollit të plotë dhe hetimi administrativ bëhen në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.”.

Neni 13

Në nenin 27 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Titulli i nenit “Korrigjimi i gabimeve në deklarim” zëvendësohet me titullin “Thirrja e subjektit për të dhënë shpjegime”.

b) Në fund të nenit shtohen fjalët “brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.”.

Neni 14

Në nenin 29, fjalia e dytë e paragrafit të dytë ndryshohet si më poshtë:

“Ekspertët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave që sigurojnë gjatë ekspertimit, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Shpenzimet e ekspertëve përballohen nga buxheti i Inspektoratit të Lartë.”.

Neni 15

Në nenin 31 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Fjalia e parë e paragrafit të parë ndryshohet si më poshtë:

“Në bazë të fletë-kontrolleve hartohen raporte me të dhënat, që i paraqiten për miratim Inspektorit të Përgjithshëm.”.

2. Pas paragrafit të parë shtohen paragrafët e dytë e të tretë me këtë përmbajtje:

“Kontrolluesi i ILDKP-së merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi, në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale.

Punonjësit e ILDKP-së, që vihen në dijeni për të dhënat e deklaramit të pasurisë, për shkak të ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.”.

Neni 16

Në nenin 32, pas fjalëve “organet tatimore” shtohen fjalët “të cilët detyrohen të njoftojnë, rast pas rasti, Inspektoratin e Lartë për masat e marra”.

Neni 17

Neni 34 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 34 **Publikimi**

1. Të dhënat, që grumbullohen nga deklarimi, sipas këtij ligji, janë të lejueshme për publikun vetëm në përputhje me ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” dhe me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.”.

2. Publikimi i të dhënave që deklarohen pranë Inspektoratit të Lartë bëhet nga ky i fundit vetëm pasi të ketë kryer kontrollin paraprak dhe aritmetik e logjik të këtyre të dhënave, duke i shoqëruar njëkohësisht me vërtetimin përkatës mbi rezultatin e këtij kontrolli.”.

Neni 18

1. Pas kreut III shtohet kreu IV me titull “Kundërvajtjet administrative”.
2. Pas nenit 39 shtohen nenet 40 dhe 41 me këtë përmbajtje:

“Neni 40 **Kundërvajtjet administrative**

1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar më poshtë:

a) Për mosdeklarim periodik apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

b) Për moslëshim autorizimi, sipas nenit 10 të këtij ligji, zyrtari dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

c) Kur nuk jepen të dhënat e kërkuara nga Inspektorati i Lartë, sipas nenit 26 të këtij ligji, personat përgjegjës të institucioneve publike dhe private dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

ç) Kur ekspertët refuzojnë kryerjen e ekspertimit ose kur ata nuk paraqiten, pa shkaqe të arsyeshme, për kryerjen e ekspertimit, sipas nenit 29 të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë;

d) Për shkelje të tjera të këtij ligji, të përcaktuara me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm e të konstatuara gjatë veprimtarisë kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, Inspektori i Përgjithshëm dënon personat përgjegjës me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.



2. Të drejtën për vendosjen e masave administrative për rastet e shkeljeve të mësipërme e ka Inspektori i Përgjithshëm.

3. Procedurat për zbatimin e masave administrative dhe ankimin ndaj tyre rregullohen sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe dispozitave të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

4. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative të konstatuara gjatë kryerjes së inspektimeve të Inspektoratit të Lartë bëhet jo më vonë se 6 muaj pas konstatimit të shkeljes.

Neni 41

Ekzekutimi i gjobave

Të ardhurat nga gjobat dhe të ardhurat e tjera të mbledhura në zbatim të dispozitave të këtij ligji kalojnë të gjitha në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i gjobës.

Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga punëdhënësi kur kundërvajtësi është në marrëdhënie pune ose nga zyra e përmbarimit, me kërkesën e Inspektorit të Përgjithshëm.”.

Neni 19

Kudo në këtë ligj, emërtimi “Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”.

Neni 20

Dispozitë kalimtare

Për efekt të deklarimit të shpenzimeve të deklarueshme, sipas nenit 1 pika 7 të këtij ligji, shpenzime të deklarueshme janë ato që kryhen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.9.2012

**Shpallur me dekretin nr.7776, datë 9.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 86/2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9367, DATË 7.4.2005 “PËR
PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE
PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10, pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

“2/1. Çdo institucion, i cili vihet në dijeni me të dhëna personale të çdo zyrtari, detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit, nëse diçka e tillë nuk është parashikuar ndryshe në ligj.

2/2. Përmbajtja e autorizimit bëhet në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale.”.

Neni 2

Në nenin 19 pika 1, fjalët “sipas seksioneve 1 e 2 të këtij kreu” zëvendësohen me fjalët “sipas seksionit 1 të këtij kreu”.

Neni 3

Në nenin 21, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III seksioni 2 të këtij ligji, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik.”.

Neni 4

Në nenin 23 pika 1, fjalët “kur kjo mund të shkaktojë lindjen e konfliktit të interesit të çdo lloji” hiqen.

Neni 5

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 29

Kufizimet për kryetarin e bashkisë, të komunës dhe të këshillit të qarkut

Kryetari i bashkisë, i komunës dhe i këshillit të qarkut:

- a) nuk mund të jenë drejtues të organizatave fitimprurëse;
- b) nuk mund të jenë anëtarë në organet drejtuese të një shoqërie tregtare ose në një organizatë jofitimprurëse, që ushtron veprimtarinë brenda territorit të juridiksionit të tyre;
- c) nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijojnë të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, përbaruesit privat, administrator i falimentit, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave, të përcaktuara në shkronjën “b” të këtij neni, dhe nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;
- ç) nuk mund të zotërojnë, në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare që ushtron veprimtarinë brenda territorit të juridiksionit të tyre.”.

Neni 6

Në nenin 32 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në paragrafin e parë, fjala “drejtpërdrejt” hiqet.
2. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:
“c) përcaktimi i kategorisë së zyrtarëve të administratës tatimore e doganore, që u nënshtrohen kufizimeve të parashikuara në këtë nen, bëhet me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm.”.

Neni 7

Në nenin 37 bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 1, në fund të shkronjës “b” shtohen fjalët:
- “ose, në rastin e organit kolegjal, duke mos marrë pjesë në diskutimin dhe votimin e çështjes në konflikt.”.
2. Në fund të pikës 9 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Zyrtari, eprori ose institucioni epror njoftojnë, në çdo rast, Inspektoratin e Lartë për masat e marra për trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave.”.

Neni 8

Në nenin 40, pikat 6 dhe 7 shfuqizohen.

Neni 9

Pas nenit 40 shtohet neni 40/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 40/1

Rregullimi i pasojave juridike të akteve të marra në kushtet e konfliktit të interesave

1. Inspektorati i Lartë ndërmerr nismën e ankimit në rrugë administrative për shpalljen e pavlefshmërisë së akteve a kontratave administrative dhe/ose revokimit/shfuqizimit të tyre nga organet kompetente në çdo rast kur, mbi bazën e verifikimit dhe hetimit administrativ, konstaton konflikt të interesave në zbatim të këtij ligji.

2. Kur një akt i një institucioni publik bëhet i pavlefshëm, sipas përcaktimeve të pikave 1, 2, 3 e 4 të nenit 40 të këtij ligji:

a) institucioni publik, kur gjykon se zyrtari ka vepruar me keqbesim, brenda 30 ditëve nga njoftimi:

i) ndërmerr procedurat e dënimit disiplinor ndaj zyrtarit, shkaktar i pavlefshmërisë së aktit;
ii) përdor të gjitha mjetet ligjore për kalimin e barrës së dëmshpërblimit të ky zyrtar;
iii) i kërkon gjykatës përkatëse edhe vendosjen e një shpërblimi në favor të institucionit për dëmin moral të shkaktuar;

iv) bën kallëzim penal ndaj zyrtarit, nëse gjykon se shkelja e kryer nga ai përbën veprë penale;

b) përcaktimet e shkronjës “a” të kësaj pike mund të zbatohen edhe ndaj çdo zyrtari tjetër përgjegjës, që me veprimet apo mosveprimet e veta nuk ka parandaluar konfliktin e interesit, shkak për pavlefshmërinë e aktit, ose për moszbatimin e detyrimeve, sipas shkronjës “a” të kësaj pike;

c) përcaktimet e shkronjës “a” të kësaj pike zbatohen për zyrtarin në konflikt interesi, shkak të pavlefshmërisë së aktit, sipas rasteve të mëposhtme:

i) në rastin e deputetit, për votën e dhënë si deputet, zbatohet vetëm shkronja “a” nënndarja “i” e kësaj shkronje;

ii) në rastin e gjyqtarit, për vendimet gjyqësore të marra prej tij ose për votën e tij në një vendim gjyqësor, nuk zbatohet shkronja “a” nënndarjet “ii” e “iii” të kësaj shkronje;

iii) në rastin e prokurorit, në ushtrim të detyrës, nuk zbatohet shkronja “a” nënndarjet “ii” e “iii” të kësaj shkronje;

ç) për zyrtarët e tjerë, që ushtrjnë funksione kontrolli ose hetimi, përcaktimet e shkronjës “a” nënndarjet “ii” e “iii” të kësaj shkronje nuk janë të detyrueshme, por vlerësimi i tyre i mbetet eprorit dhe, në mungesë apo mosveprim të tij, institucionit epror;

d) veprimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni kryhen nga institucioni publik, sipas rastit, edhe kundër personit të lidhur, personit të besuar ose çdo personi tjetër bashkëpërgjegjës.

3. Në rastin kur vetë institucioni publik nuk e merr këtë nismë, sipas shkronjës “a” të pikës 2, institucioni epror, duke filluar nga ai më i afërti e me radhë, sipas kompetencave ligjore, zbaton detyrat e përcaktuara në të. Në mungesë të veprimit të tyre, detyrat e përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 2 zbatohen nga Inspektorati i Lartë, i cili, sipas rastit, bashkëpunon me Avokaturën e Shtetit.

4. Kundër vendimeve të Inspektoratit të Lartë për konstatimin e konfliktit të interesave në aktet dhe kontratat administrative mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda 45 ditëve nga njoftimi i vendimit.

Neni 10

Në nenin 41 pika 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Inspektorati i Lartë vihet në lëvizje me kërkesë të institucioneve publike, palëve të interesuara dhe kryesisht me nismën e tij.”.

Neni 11

Në nenin 42 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “ë” ndryshohet si më poshtë:

“ë) përcaktimin e modelit të deklarimit të interesave privatë dhe të autorizimit të deklarimit të vazhdueshëm dhe rast për rast të interesave, si dhe të regjistrimit të të dhënave që lidhen me një konflikt të tillë.”.

2. Në pikën 1, pas shkronjës “h” shtohet shkronja “h/1” me këtë përmbajtje:



“h/1) nisjen e veprimeve ligjore në institucionet publike kompetente, me qëllim shpalljen e pavlefshmërisë dhe rregullimin e pasojave që rrjedhin prej saj për aktet dhe kontratat administrative të nxjerra në kushtet e konfliktit të interesave, me kërkesën e palëve të interesuara ose me nismën e tij.”.

3. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Për verifikimin dhe hetimin administrativ të konfliktit rast për rast dhe të vazhdueshëm të interesit, Inspektorati i Lartë ka të drejtë të shfrytëzojë të dhënat e nevojshme në të gjithë aparatit shtetëror e publik dhe në personat juridikë publikë e privatë, të cilët detyrohen të vënë në dispozicion të dhënat e kërkuara nga Inspektori i Përgjithshëm, jo më vonë se 15 ditë.”.

4. Në fund të pikës 3 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Mbi bazën e raportit vjetor, Inspektori i Përgjithshëm harton vlerësime dhe rekomandime lidhur me zbatimin e këtij ligji nga autoritetet përgjegjëse dhe institucionet publike.

Për emërimin, lëvizjen apo largimin nga funksioni të autoriteteve përgjegjëse, njoftohet paraprakisht Inspektori i Përgjithshëm.”.

Neni 12

Në nenin 44 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar më poshtë:

a) për mosvetëdeklarim apo për mosdeklarim me kërkesë, në përputhje me pikat 1 e 2 të nenit 7 të këtij ligji, zyrtari dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

b) për moslëshim autorizimi, sipas pikës 2 të nenit 10 të këtij ligji, zyrtari dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

c) për shkelje të neneve 21 pikat 1, 2, 3 e 6, 22, 23 pika 1 dhe 24 pika 3 të këtij ligji, zyrtari ose personi i lidhur me të, personi i besuar ose drejtuesi i shoqërisë dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë;

ç) për shkelje të pikave 1 dhe 4 shkronjat “a”, “c” dhe “e” të nenit 37, dhe pikave 1, 2, 3, 5 e 8 të nenit 38 të këtij ligji, zyrtari ose personi i lidhur me të dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 300 000 (treqind mijë) lekë;

d) kur paraqitet gjendja e përcaktuar në shkronjat “a” e “b” të pikës 2 të nenit 40/1, zyrtari dënohet me gjobë nga 300 000 (treqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

dh) kur nuk jepen të dhënat e kërkuara nga Inspektorati i Lartë, sipas pikës 1/1 të nenit 42 të këtij ligji, personat përgjegjës të institucioneve publike dhe private dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

e) në rastet e shkeljeve të mësipërme, gjoba jepet nga Inspektori i Përgjithshëm, me propozimin e eprorit ose të institucionit epror ose, kur shkelja verifikohet drejtpërdrejt, nga Inspektorati i Lartë;

ë) për shkelje të tjera të këtij ligji, të përcaktuara me urdhër nga Inspektori i Përgjithshëm, e me propozimin e eprorit të strukturës së institucionit, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji, të institucionit epror, ose kur shkelja verifikohet drejtpërdrejt nga Inspektorati i Lartë, personat përgjegjës dënohen me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

f) për çdo masë administrative, Inspektori i Përgjithshëm njofton eprorin ose institucionin epror të zyrtarit të dënuar.”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative të konstatuara gjatë kryerjes së inspektimeve të Inspektoratit të Lartë bëhet jo më vonë se 6 muaj pas konstatimit të shkeljes.”.

Neni 13

Pas nenit 44 shtohet neni 44/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 44/1

Ekzekutimi i gjobave

Të ardhurat nga gjobat dhe të ardhurat e tjera të mbledhura në zbatim të dispozitave të këtij ligji kalojnë të gjitha në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i gjobës.

Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga punëdhënësi, kur kundërvajtësi është në marrëdhënie pune, ose nga zyra e përbarimit, me kërkesën e Inspektorit të Përgjithshëm.”.

Neni 14

Në nenin 45 pika 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Për masat disiplinore të marra nga institucionet përkatëse njoftohet rast pas rasti Inspektorati i Lartë.”.

Neni 15

Në nenin 46 pika 1, shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) procesin e identifikimit, regjistrimit, kontrollit dhe hetimit administrativ të interesave privatë të zyrtarëve, të lidhur me konfliktin, rast pas rasti, të interesit, sipas kreut II seksioni 1 të këtij ligji.”.

Neni 16

Nenet 14, 15, 16, 17 dhe 18 të seksionit 2 të kreut II të këtij ligji shfuqizohen.

Neni 17

Emërtimi “Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive” kudo në këtë ligj zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.9.2012

**Shpallur me dekretin nr.7777, datë 9.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



LIGJ
Nr. 87/2012

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 4, DATË 16.8.2012,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR
THERJEN E KAFSHËVE DHE TREGTIMIN E MISHIT TË TYRE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 16.8.2012, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre”.

Miraturar në datën 18.9.2012

**Shpallur me dekretin nr.7778, datë 9.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 88/2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8417, DATË 21.10.1998 “KUSHTETUTA E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 83 pika 1 dhe 177 të Kushtetutës, me propozimin e më shumë se një të pestës së anëtarëve të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 73 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 73

1. Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes.

2. Deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit.

3. Deputeti mund të ndalohej ose të arrestohet pa autorizim kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi. Në këto raste, Prokurori i Përgjithshëm njofton menjëherë Kuvendin, i cili, kur konstaton se nuk ka vend për procedim, vendos për heqjen e masës.

4. Për çështjet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, Kuvendi mund të diskutojë në seancë me dyer të mbyllura, për arsye të mbrojtjes së të dhënave. Vendimi merret me votim të hapur.”.

Neni 2

Neni 126 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 126

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të arrestohet apo t’i hiqet liria në çfarëdo forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e vetë gjykatës, përveçse nëse kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi. Në këtë rast, Prokurori i Përgjithshëm vë menjëherë në dijeni Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.”.

Neni 3

Neni 137 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 137

1. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë nuk mund të arrestohet apo t’i hiqet liria në çfarëdo forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Gjykatës Kushtetuese, përveçse nëse kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi. Në këtë rast, Prokurori i Përgjithshëm vë menjëherë në dijeni Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

3. Gjyqtarët gëzojnë imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tyre gjyqësore.

4. Gjyqtari nuk mund të arrestohet ose t’i hiqet liria në çfarëdo forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përveçse nëse kapet gjatë kryerjes ose menjëherë pas kryerjes së një krimi. Në këtë rast, Prokurori i Përgjithshëm vë menjëherë në dijeni Këshillin e Lartë të Drejtësisë, i cili mund të vendosë për heqjen e masës.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.9.2012

**Shpallur me dekretin nr.7779, datë 9.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



VENDIM
Nr. 37/2012

**PËR RRËZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8417,
DATË 21.10.1998 “KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, TË NDRYSHUAR
(Nisma e propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, datë 20.7.2012)**

Në mbështetje të nenit 177 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 77/b të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, (Nisma e propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, datë 20.7.2012).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 18.9.2012

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel. : 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 10.10.2012
Doli nga shtypi më 11.10.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë